

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS

Nr. 669 prot.

Tiranë, më 21.11.2018

Lënda: Për një ndryshim dhe shtesë në Strukturën dhe Organikën e Autoritetit të Konkurrencës

Z. GRAMOZ RUÇI
KRYETAR I KUVENDIT

I nderuar Z. Kryetar,

Autoriteti i Konkurrencës, në zbatim të ligjit 9584, dt.17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj”, të ndryshuar, ligjit 152/2013 “Për shërbimin civil”, i ndryshuar, VKM nr. 893/2014 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe strukturimin e brendshëm organizativ në institucionet shtetërore”, VKM 142/2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, si dhe VKM nr. 187 datë 8.3.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë....”, lidhja nr. 3, paraqet për miratim në Kuvend propozimin për një shtesë prej 3 punonjësish “Inspektorë” në strukturën aktuale të institucionit, të miratuar me Vendimin e Kuvendit nr. 59/2018 “Për disa ndryshime në Vendimin e Kuvendit 43/2017 “Për miratimin e Strukturës dhe Organikës së Autoritetit të Konkurrencës”.

- Kërkesë për shtesë në numrin e punonjësve prej 3 vetë, të cilët do të jenë Inspektorë të kategorisë III-a në drejtoritë teknike, për të mbuluar aktivitetin në rritje pasi:

1. Kjo kërkesë lidhet ngushtë me forcimin dhe me rritjen e kapaciteteve institucionale të Autoritetit të Konkurrencës, **diktuar nga Progres Raporti i Komisionit European 2018**, për Shqipërinë në të cilën thuhet shprehimisht, **“Autoriteti i Konkurrencës duhet të forcojë në mënyrë të vazhdueshme kapacitetet institucionale për zbatimin e ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës”**.


2. Kjo kërkesë e Komisionit European, lidhet me rolin që ka Autoriteti i Konkurrencës si institucion **lider dhe koordinator i kapitullit 8-të, të MAS-së “Politika e Konkurrencës dhe liberalizimi”**.
3. Struktura e re e miratuar me Vendimin e Kuvendit 59/2018, dikton gjithashtu nevojën që Autoriteti i Konkurrencës në funksion të **inspektimit të tregjeve në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë**, të mbulojë ato dhe t’u përgjigjet nevojave të konsumatorit shqiptar, për një konkurrencë të lirë dhe efektive.

Efekti financiar për shtesën prej tre vetë të paraqitur nga Autoriteti i Konkurrencës është 3,7 milion lekë.

Duke ju falenderuar, me konsideratën më të lartë.

Me respekt,

KRYETARE



ORGANIKA E AUTORITETIT TE KONKURRENCËS, SHOQËRUAR ME KATEGORIZIMIN
E PAGËS PËR ÇDO POZICION

POZICIONI	NUMRI	
I. KRYETAR	(1)	
II. KOMISIONER	(4)	
III. KABINETI	(3)	
Drejtor kabinet		1
Keshilltar		1
Sekretar		1
IV. SEKRETAR I PERGJITHSHEM	(1)	
V. DREJTORIA E MBIQYRJES SE TREGJEVE PRODHUESE	(7)	
Drejtor II-b		1
Inspektor III-a		6
VI. DREJTORIA E MBIQYRJES SE TREGJEVE TE SHERBIMIT/ JO PRODHUESE	(7)	
Drejtor II-b		1
Inspektor III-a		6
VII. DREJTORIA E ANALIZES DHE METODOLOGJISE SE TREGJEVE	(7)	
Drejtor II-b		1
Inspektor III-a		6
VIII. DREJTORIA JURIDIKE DHE E CESHTJEVE GJYQESORE	(6)	
Drejtor II-b		1
Inspektor për vlerësimin e legjislacionit III-a		3
Inspektor për procedurat e hetimit III-a		2
IX. DREJTORIA E INTEGRIMIT DHE KOMUNIKIMIT	(5)	
Drejtor II-b		1
Specialist III-b		4
X. DREJTORIA E SHERBIMEVE MBESHTETESE	(5)	
Drejtor II-b		1
Specialist financë/buxhet III-b		1
Specialist protokoll/arkive IV-a		1
Shofer Kl. IV (VKM nr.717, datë 23.6.2009 i ndryshuar)		1
Punonjes pastrimi		1

Gjithsej :

(46)

STRUKTURA E AUTORITETIT TË KONKURENCËS

